

GJYKATA SUPREME E KOSOVES

Ap-Kz no.166/2012

4 Dhjetor 2012

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, me trup gjykues të përbërë nga Gjyqtari Horst Proetel si Kryetar i Trupit Gjykues dhe Gjyqtar Raportues , dhe Gjyqtaret e Gjykatës Supreme Valdete Daka, Marije Ademi dhe Salih Toplica, si dhe Gjyqtari i EULEX-it Tore Thomassen si anëtare te trupit gjykues, në praninë e Chiara Rojek, Zyrtare Ligjore duke vepruar si procesverbal mbajtëse,

Në procedurën penale kundër **A.S.**, me nofken **K.K.** **Dj.**, emri i babait **I.** lindur me **xxx** në **xxx** me banim në **xxx** e Prishtinës, Kosovë, shtetas i Kosovës, momentalisht ne paraburgim, I ngarkuar sipas Aktakuzës P P no. 618/2003 e ngritur më 24 Gusht 2007 nga ana e Prokurorit të Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) tek Gjykata e Qarkut në Prishtinë me **Rrezikim të Sigurisë** në kundërshtim me Nenin 48 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK) ekuivalent me Nenin 161 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK-së) dhe me **Terrorizëm** në kundërshtim me nenit 5.3 të Rregullores se UNMIK-ut nr. 2001/12 mbi Ndalimin me Ligj të Terrorizmit dhe Veprave Përkatëse të 14 Qershorit 2001 ekuivalent me Nenin 113 paragrafi 3 i KPPK-së (Pika 1), **Shkaktim i Rrezikut të Përgjithshëm** në kundërshtim me Nenin 157 paragrafi 3 i LPK-së ekuivalent me Nenin 291 paragrafi 3 i KPPK-së, **Terrorizëm** në kundërshtim me nenin 2.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/12 mbi Ndalimin me ligj të Terrorizmit dhe Veprave Përkatëse, Nenit 109 paragrafi 7 dhe 10 të KPPK-së , dhe **Mbajtje e Paligjshme e Armëve** në kundërshtim me nenin 8,2 i lidhur me nenin 8,6 të Rregullores se UNMIK-ut nr.2001/7 mbi Autorizimin e Armëmbajtjes në Kosovë më 21 Shkurt 2001 ekuivalent me Nenin 328 paragrafi 1 dhe 2 i KPPK-së (Pika 2), dhe **Armëmbajtje pa leje** në kundërshtim me nenin 8.2 i lidhur me Nenin 8.6 të Rregullores e UNMIK-ut nr. 2001/7 ekuivalent me Nenin 328 paragrafi 1 dhe 2 të KPPK-së (Pika 3),

Të dënuar nga shkalla e parë me Aktgjykimin P no. 461/07 të Gjykatës se Qarkut të Prishtinës me datën 29 Qershor 2011 me te cilën i pandehuri **A.S.** u gjet fajtor për **Terrorizëm** në kundërshtim me nenit 5.3 të Rregullores se UNMIK-ut nr. 2001/12 mbi Ndalimin me Ligj të Terrorizmit dhe Veprave Përkatëse i lidhur me Udhëzimet Administrative të UNMIK-ut nr.2003/9 ekuivalent me Nenin 113 paragrafi 3 i Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) (Pika 1), **Terrorizëm** në kundërshtim me nenin 2.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/12 mbi Ndalimin me ligj të Terrorizmit dhe Veprave Përkatëse i lidhur me nenin 1, shkronja (a), numrat vii dhe x ekuivalent me Nenin 110 paragrafi 1 i lidhur me Nenin 109 paragrafi 1 pikat 7 dhe 10 të KPK-së (Akuza 2), dhe me **Armëmbajtje pa leje** në kundërshtim me nenin 8.2 dhe 8.6 të Rregullores e UNMIK-ut nr. 2001/7 mbi Autorizimin e Armëmbajtjes në Kosovë më ekuivalent me Nenin 328 paragrafi 2 i KPK-së (Pika 3) dhe me te cilin iu dha dënimi i akumuluar prej dhjetë(10) vitesh e një (1) muaj



Duke vepruar sipas Ankesës e paraqitur më 17 Prill 2012 nga Avokati Mbrojtës S. ne emër të të pandehurit A.S. kundër Aktgjykimit P bo. 461/07 te Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me datë 29 Qershor 2011, dhe duke marrë parasysh Mendimin dhe Kërkesën e Ankesës se paraqitur me 16 Maj 2012 nga Zyra e Prokurorit te Shtetit (ZYSH),

Pas mbajtjes se seancës publike me 4 Dhjetore ne prani te Avokatit Mbrojtës S. dhe Prokurorit te Shtetit Jusuf Mejzini qe përfaqësonte ZPSK, dhe pas konsultimit dhe votimit me 4 Dhjetor 2012,

Ne pajtim me Nenin 420 dhe duke ndjekur Kodin e Procedurës Penale te Kosovës (KPPK-se) leshin këtë,

AKTGJYKIM

1. Aktgjykimi P no. 461/07 I Gjykatës se Qarkut te Prishtinës me date 29 Qershor 2011 **NDRYSHOHET** sipas detyrës zyrtare me ç ‘rast Pika 3 është I përfshire ne Piken 2.
2. Pjesët tjera te Aktgjykimit te sfiduar **KONFIRMOHEN**
3. Ankesa e paraqitur me 17 Prill 2012 ne emër te të pandehurit A.S. kundër Aktgjykimit P no. 461/07 te Gjykatës se Qarkut te Prishtinës me date 29 Qershor 2011 **REFUZOHE** si e pa baze.

ARSYETIMI

I. Historia procedurale dhe faktike

1. Me 10 Maj 2003, I.B. I cili ne at kohe ishte xxx pranoi nje letër e nënshkruar nga K.R.E. Armatës Kombetare Shqiptarë , duke adresuar kërcënime me vdekje ndaj B. ër shkak te qëndrime te tija anti ANA (Albanian National Army- Armata Kombëtare Shqiptare). Me 20 Korrik 2003 rreth orës 21:00 një projekti ishte hedhur ne ndërtesën e Gjykatës e Qarkut ne Prishtinë e cila gjendet ne një lokacion te dendur urban te banimit me popullatë. Projektimi shkaktoi një vrimë konstruktin e ndërtesës se gjykatës dhe depërtoi ne zyrën e Krye Prokurorit te Qarkut, xxx
2. Hetimet ne lidhje me këtë ndodhi filluan me 2003. I dyshuari A.S. nuk mund te gjendej deri sa ai u kap me 26 Shkurt 2007. Me 1 Mars 2007 , vendimi qe te kryhen hetimet preliminare HEP no. 521/2003 u lëshua.¹ Pas seancës dëgjimore masa e paraburgimit u caktua kundër A.S. te njëjtën dite. Me 18 Gusht 2007, ai iku nga qendra e paraburgimit te burgut te Dubraves.
3. Me 24 Gusht 2007, Prokurori Publik ngiti aktakuzën PP no. 618/2003 kundër për veprat penale si ne vijim:². Rrezikim te sigurisë ne kundërshtim me Nenin 161 LPK-se ekuivalent me Nenin 161 te KPPK-se dhe Terrorizëm ne kundërshtim me Nenin

¹ Dosja e përhirte, dosja e prokurorisë, HEP no 521/03, vëllimi II, faqja 656

² Dosja e përhirte, dosja e prokurorisë, HEP no 521/03, vëllimi III



5.3 te Rregullores e UNMIK-ut no. 2001/12 mbi Ndalimin me Ligj te Terrorizmit dhe Veprave Relevante ekuivalent me Nenin 109 paragrafin 7 dhe 10 te KPPK-se, Mbajtje e kundërligjshme e Armeve ne kundërshtim me nenin 8.2 I lidhur me nenin 8.6 te Rregullores e UNMIK-ut no. 2001/7 ekuivalent me Nenin 328 paragrafi 1 dhe 2 I KPPK-se (pika 2) dhe Mbajtje e kundërligjshme e Armeve ne kundërshtim me nenin 8.2 I lidhur me nenin 8.6 te Rregullores e UNMIK-ut no. 2001/7 ekuivalent me Nenin 328 paragrafi 1 dhe 2 I KPPK-se (pika 3).

4. Me 27 Gusht 2007, një Urdhër për arrest P no. 461/2007 u lëshua kundër **A. S.** nga një trup prej tre gjyqtareve te Gjykatës se qarkut te Prishtinës. Me 13 Shkurt 2011 I Pandehuri me ne fund u kap dhe u paraburgos.

5. Me 5 Prill 2011, Aktakuza PP no. 618/2003 u konfirmua me Aktvendimin KA no. 135/2011 ne lidhje me piken 1 (**Terrorizëm** ne kundërshtim me nenin 5.3 te Rregullores se UNMIK-ut no 2001/12), pika 2 (**Terrorizëm** ne kundërshtim me nenin 2.1 I lidhur me nenin 1, vii dhe x te Rregullores se UNMIK-ut no. 2001/12) dhe pika 3 (**Mbajtja ne posedim te paligjshëm te armeve** ne kundërshtim me nenin 8.2 I lidhur me nenin 8.6 te Rregullores se UNMIK-ut no. 2001/7). I Pandehuri u deklarua fajtor për piken 3.

6. Shqyrtimi kryesor filloi me 11 Maj 2011. Disa dëshmitare, sidomos dëshmitare ekspert, u dëgjuan dhe provat u prezantuan. Me 29 Qershor 2011, Gjykata e Qarkut ne Prishtinë lëshoi Aktgjykimin P no. 461/07³ me te cilën **A. S.** u shpall fajtor për:


- Pika 1: Terrorizëm ne kundërshtim me nenin 5.3 te Rregullores e UNMIK-ut no. 2001/12 mbi Ndalimin me ligj te Terrorizmit dhe Veprave Përkatëse I lidhur me Udhëzimet Administrative te UNMIK-ut no. 2003/9, ekuivalent me Nenin 113 paragrafi 3 I KPK-se.⁴

- Pika 2: Terrorizëm ne kundërshtim me nenin 2.1 te Rregullores e UNMIK-ut no. 2001/12 mbi Ndalimin me Ligj te Terrorizmit dhe Veprave Përkatëse I lidhur me neni 1, shkronja (a), numrat vii dhe x, ekuivalent me Nenin 1110 paragrafi 1 I lidhur me Nenin 109 paragrafi 1 , pika 7 dhe 10 I KPK-se⁵ Dhe

³ Dosja e kaltër KA no. 135/2011 **A.S** nga aktakuza, ndarësi 15

⁴ Sepse Më 10 Maj 2003 **A.S**, i njohur gjithashtu si **K.K.** aktivisht morri pjese ne organizate terroriste, domethënë, Armata Kombëtare Shqiptare (AKSH). AKSH u definua me Urdhëresën Administrative No. 2003/9 me datë 17 Prill 2003 si organizate terroriste, anëtarësimi ose aktivitet tjetër ne të cilin ndërbejnë vepër penale. **A.S.** tivisht mori pjesë në organizate terroriste duke dërguar letër **I.B.** cili ne atë kohe mbante pozitën e **xxx xxx xxx**. Letra ishte e nënshkruar nga **K.R.** i Armatës Kombëtare Shqiptare dhe shenjetroi te adresuarin me kërcenim vdekje për shkak te qëndrimeve anti AKSH te tij.

⁵ Për shkak se me 20 Korrik 2003 rreth orës 21:00, **A.S.** I njohur gjithashtu si **K.K.** me qellim qe te shkaktoj kërcenim serioz ndaj rendit publik, ne mënyre te paligjshme posedoi raketë-hecnes dore 'ZOLA' te modelit 80 me kalibër 64 mm No. 881+1233, I prodhuar ne ish-Republikën Jugosllave, dhe qëllon ndërtesën e Gjykatës se Qarkut te Prishtinës e cila gjendet ne mes ten je zone te dendur te banuar me popullatë me ndërtesa banimi dhe afariste ne afërsi, kështu shkaktoi rrezik te përgjithshëm. Projekti shkaktoj vrime prej 20x20 cm ne gjykatore dhe hyri Brenda zyrës se Krye Prokurorit **M.S.** **A.** ishte ne atë kohe anëtarë aktiv I organizatës terroriste Armata Kombëtarë Shqiptare (AKSH) sjellja e tij shkaktoi rrezik te përgjithshëm duke rrezikuar jetë njerëzish, si dhe prona te vlerave substanciale.



- Pika 3: Mbjtje ne posedim te paligjshëm te armeve ne kundërshtim me nenin 8.2 dhe 8.6 te Rregullores e UNMIK-ut no. 2001/7 dhe Autorizimi mbi Posedimin e Armeve ne Kosove ekuivalent me Nenin 328 paragrafi 2 I KPK-se⁶

7. Ai u dënua me një (1) vit burg ne piken 1, dhjete (10) vjet burgim për piken 2 dhe nje (1) vjet burgim për piken 3. Sipas Nenit 48 paragrafi 2 nen-paragrafi 3 I lidhur me Nenin 38 paragrafi 4 te Kodit Penal te Republikës Socialiste Federative te Jugosllavisë te vitit 1977 (KP RSFJ-se) dënimi akumulativ për kohëzgjatje prej dhjete (10) vjetësh dhe një (1) muaji u caktua kundër tij. Trupi Gjykues urdhëroi qe koha e kaluar ne paraburgim nga I Pandehuri **A.S.**⁷ te kreditohet si pjese e dënimit.

8. Me 17 Prill 2012, Avokati Mbrojtës **S.J.** paraqiti ankese kundër Aktgjykimit te Shkalles se Pare. Ai pretendon shkelje substanciale te dispozitave te procedurës penale sipas Nenit 403 te KPPK-se, shkelje te ligjit penal nen Nenin 404 te KPPK-se, dhe përcaktimi i gabuar dhe/ose jo I plote I gjendjes faktike sipas Nenit 406 te Kodit. Ai pra propozon qe te bej ndryshime aktgjykimin e kontestuar qe te liroj te Pandehurin, ose si zëvendësim te caktoje një dënim me te lehte, ose qe te anuloj aktgjykimin dh eta kthej çështjen për ri-shqyrtim. Për me tepër, Mbrojtja kërkon qe te ndërpritet masa e paraburgimit kundër **A.S.** ne pajtim me Nenin 424 paragrafi 6 I KPPK-se. Me 16 Maj 2012, ne Mendimin dhe Kërkesën e tij, Prokurori I Shtetit propozon qe te refuzohet Ankesa se e pabaze dhe te vërtetohet Aktgjykimi I kontestuar.

II. Gjetjet e Gjykatës Supreme te Kosovës

II.A. Kompetenca e Gjykatës Supreme te Kosovës

9. Gjykata Supreme e Kosovës ka kompetence qe te vendose mbi Ankesën e paraqitur ne pajtim me Nenin 26 paragrafi 1 dhe Neni 398 te KPPK-se. Trupi Gjykues I Gjykatës Supreme është bere ne pajtim me Nenin 36 te KPPK-se, Ligji mbi juridiksionin no. 03/L-053 , përzgjedhja dhe caktimi e çështjeve te Gjyqtareve dhe Prokuroreve te EULEX-it ne Kosove me date 13 Mars 2008, dhe Udhëzimet mbi Caktimin e Qeshjeve për Gjyqtaret e EULEX-it ne Çështjet Penale tek Gjykata Supreme e Kosovës me date 24 Mars 2011.

II. B. Pranueshmeria e Ankesës e paraqitur nga Mbrojtja

10. I Pandehuri **A.S.** pranoi Aktgjykimin e sfiduar me 5 Prill 2012. Avokati I tij Mbrojtës **S.J.** paraqiti ankese kundër Aktgjykimit te Shkalles se Pare me 17 Prill 2012. Kështu qe Ankesa është e pranueshme dhe e paraqitur me kohe nga nje person I autorizuar ne pajtim me Nenin 398 paragrafi 1 dhe 2 dhe 399 paragrafi 1 I KPPK-se.

⁶ Për shkak se prej një periudhe te pacaktuar kohore deri me 23 Korrik 2003 ne Kosovë, njohur gjithashtu si **K.K.** posedoi tri armë AK 47 me numra serik 3124350, 75492, 0192285 dhe katër karikator me municion duke mos pasur lejen autorizuese te armëve.
⁷ Prej 26 Shkurtit 2007 deri me 18 Gusht 2007 dhe prej 13 Shkurtit 2011 deri sa ky Aktgjykim te behet e formës se prerë



II. C. Meritat e Ankesës

11. Gjykata Supreme e Kosovës e hedh poshtë si te pa baze Ankesën e paraqitur ne emër te te Pandehurit **A.S.** Trupi Gjykues i nënshkruar procedon sipas detyrës zyrtare amendamenti I Aktgjykimit te Shkalles se Pare kështu qe Pika 3 përfshihet nen Piken 2, dhe vërteton pjesët tjera te Aktgjykimit te sfiduar.

Akuzat se shkeljet esenciale te dispozitave te procedurës penale sipas Nenit 403 paragrafi 1 dhe nen paragrafi 8 dhe 12 te KPPK-se janë bere

12. Avokati Mbrojtës pretendon se Shkalla e Pare nuk ka ofruar asnjë arsyetim për sa I përket argumenteve te Mbrojtjes dhe ne faktet vendimtare. Ai gjithashtu pretendon paqëndrueshmëri ne mes te konkluzioneve te Gjykatës se Shkalles e Pare dhe deklaratave te dëshmitareve qe përmbajnë kontradikta ne lidhje me kahjen e marrur nga kryesi I veprës pas gjuajtjes ne ndërtesën e Gjykatës se Qarkut ne Prishtine.

13. Ne anën tjetër, Prokurori Shtetëror thotë se dispozitivi I Aktgjykimit është gjithëpërfshirës dhe ka ne vehte te gjitha faktet vendimtare, dhe se arsyetimi I Aktgjykimit te kontestuar sjell justifikime te mjaftueshme me konkluzat te qarta dhe bindëse ne faktet vendimtare.

14. Trupi Gjykues I Gjykatës Supreme duhet te jete I një mendje me pikëpamjet e Prokurorit te Shtetit. Ne fakt shihet se dispozitivi është gjithëpërfshirës dhe përmban te gjitha elemente e detyrueshme siç edhe kërkohet ne Nenin 296 paragrafi 3 dhe 4 I lidhur me Nenin 391 te KPPK-se.⁸

15. Njëllonj kjo Gjykate nuk ka identifikuar ndonjë paqëndrueshmëri interne ne dispozitiv, ose ndonjë mospërputhje me bazat e aktgjykimit. Gjykata e Shkalles se Pare sjell një arsyetim te gjate mbi elementet ligjore dhe faktike te lidhura me tri akuzat për te cilat **A.S.** u shpalle fajtor, qe eventualisht qojnë tek konkluzione te drejta mbi faktet vendimtare.⁹ Ngjashëm, nuk ka papelqyeshmeri ne mes te asaj qe u gjet nga Gjykata e Qarkut dhe deklaratave te dëshmitareve ne aktgjykimin e kontestuar. Gjykata e Shkalles se Pare shqyrtoi besueshmërinë e dëshmitareve si dhe peshën dhe rëndësinë e deklaratave te tyre, qe te konkludoi se “sipas mendimit te këtij paneli nuk kishte mospërputhje ne mes te deklaratave te **Z.B.** dhe dëshmitarit anonim dhe ne përgjithësi ato vërtetohen. Duke pasur tregimin gjithëpërfshirës te dëshmitarit okular anonim, paneli ishte I mendimit se kjo deklarate ishte me përparësi me te larte¹⁰. Paneli I Gjykatës Supreme ne lidhje me ketë e referohet arsyetimit te detajuar te tij nen Pjesën “ Akuzimet se përcaktimi I gjendjes faktike I bere nga Gjykata e Shkalles se Pare ka qene I gabueshëm” (para 26 dhe ne vazhdim te këtij Aktgjykimi) te vet këtij aktgjykimi ne ketë pike.

⁸ Gjykata e Qarkut të Prishtinës, çështja P.no 461/07. Aktgjykim I Shkalles se Parë. 29 Qershor 2011

⁹

¹⁰ Ibid faqe 5-12: ligji i aplikueshëm (faqe 5 dhe 7), definicioni i aktit të terrorizmit (faqe 6) dhe elementeve evidenciale ne lidhje me Akuzën I dhe përgjegjësia penale e **A.S.** (faqe 7-8)

¹¹ Ibid faqe 11



16. Duke pas parasysh atë që u tha me lart, asnjë shkelje esenciale e procedurës penale nuk është kryer nga Gjykata e Shkalles së Parë nën Nenin 403 paragrafi 1 nën paragrafi 8 dhe 12 I KPPK-se.

Akuzimet se shkelja e ligjit penal ndodhi si rezultat i shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale

17. Në pikëpamjet e Mbrojtjes, Gjykata e Shkalles së Parë gabimisht ka aplikuar Rregulloren e UNMIK-ut no. 2001/12 mbi Ndalimin me Ligj të Terrorizmit, Rregulloren e UNMIK-ut no. 2001/7 mbi Autorizimin mbi Mbajtjen e Armeve në Kosovë dhe LPK dhe dënoi **A.S.** në baze të “dispositive norm” jo të dispozitave ligjore. Avokati Mbrojtës për më tepër argumenton faktin se **A.S.** ishte dënuar për dy vepra penale – përdorimi dhe mbajtja në pronësi e armeve -, edhe pse përben të njëjti veprim. Përfundimisht, Gjykata e Shkalles së Parë dështoi që të vërtetojë qëllimin e të Pandehurit dhe neglizhojë parimin *in dubio pro reo*.

18. Prokurori Shtetëror pohon se Gjykata e Shkalles së Parë me të drejtë aplikoi dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut no. 2001/12 dhe no. 2001/7 në pajtim me Nenin 354 të KPK-se.

19. Sipas dispozitivit të Aktgjykimit të atakuar, **A.S.** ishte shpallur fajtor për shkeljet e Rregullores së UNMIK-ut no 2011/12 dhe Rregullores së UNMIK-ut no. 2001/7. Dispozitvi dhe arsyetimi gjithashtu përmbajnë referenca të dispozitave të ligjit të tanishëm I cili paralizojn veprat e kryera, me fjale tjera Neni 113 paragrafi 1 pika 7 dhe 10 të KPK-se (Pika 2) dhe Neni 328 paragrafi 2 I KPK-se. Në Aktgjykimin e Shkalles së Parë, Paneli theksoi:

“duke u bazuar në nenin 8 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/12 “ Mbi Ndalimin me Ligj të Terrorizmit dhe Veprave Përkatëse” Përfaqësuesi Special I Sekretarit Gjeneral lëshoi një udhëzim administrativ për implementimin e dispozitës ligjore të përmendur me datën 17 Prill 2003- udhëzimi administrativ no. 2003/09 që e deklaroi Armatën Kombëtare Shqiptare si organizatë terroriste siç është definuar me nenin 1 (f) të Rregullores së UNMIK-ut No 2001/12. Në nenin 2 thuhet se anëtarësimi ose pjesëmarrja aktive do të duhej të përbeje krim I dënueshëm nën nenin 5 të Rregullores së UNMIK-ut No 2001/12. Duke u bazuar në nenin 354 të KPK-se paneli vlerësoi që ai udhëzim administrativ është ende në fuqi. Udhëzimi administrativ No 2003/9 nuk bie nën sferën e “ dispozitave e Udhëzimeve Administrative që mbulojnë qeshjet e prekura në Kodin e Tanishëm” pasi që qëllimi I asaj dispozite ligjore ishte implementimi I rregullores mbi ndalimin e terrorizmit dhe veprave përkatëse dhe jo krijimin e nje kategorie të re të veprave penale. Duke e konsideruar faktin se Armata Kombëtare Shqiptare tashme është shpallur organizatë terroriste ky trup gjykues nuk ishte I obliguar që të beje ndonjë shqyrtim shtese nëse AKSH bie nën sferën e definicionit të organizatës terroriste siç është e definuar nën nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut no. 2001/12 mbi ndalimin me ligj të terrorizmit dhe veprave përkatëse”¹¹

20. **A.S.** u shpall fajtor për dërgimin e letrës kërcënuese nën nenin 354 të Rregullores së UNMIK-ut no. 2001/12. Kjo dispozite thotë se “ çdo person që...

¹¹ Ibid faqe 7



aktive merr pjese ne organizate terroriste kryen vepër penale dhe do ti nënshtrohet dënimit me burgim për kohëzgjatje prej një (1) deri ne dhjete (10) vite” Vepra themelore është “aktivisht te merret pjese ne organizate terroriste” Organizata terroriste është e definuar sipas Nenit 1.¹² Sipas Udhëzimit Administrativ no. 2003/9, “ AKSH – Armata Kombëtare shqiptare është organizate terroriste siç është e definuar me nenin 1 (f) te Rregullores se UNMIK-ut No. 2001/12. Udhëzimi gjithashtu paralizoi anëtarësimin ose pjesëmarrjes aktive nr AKSH si krim I dënueshëm sipas nenit 5 te Rregullores se UNMIK-ut no. 2001/12.

21. Ky Udhëzim Administrativ u lëshua nga Përfaqësuesi Special I Sekretarit Gjeneral (PSSG) ne pajtim me nenin 8 te Rregullores se UNMIK-ut no. 2001/12 sipas te cilit ai/ajo “ mund te lëshoj udhëzime administrative për implementimin e rregulloreve te tanishme”. Për me tepër Rregullorja e UNMIK-ut no. 2001/12 është shpallur “ ne pajtim me autorizimin qe I është dhëne atij sipas rezolutës se Këshillit te Sigurimit te Kombeve te Bashkuara 1244 (1999) te 10 Qershorit 1999” dhe “ duke e marre parasysh Rregulloren No 1999/1 te 25 Korrikut 1999 te Misionit te Përkohshëm te Kombeve te Bashkuara ne Kosove (UNMIK), I ndryshuar, mbi kompetencat e Administratës se Përkohshme ne Kosove, dhe Rregulloren e UNMIK-ut No 1999/24 te 12 Dhjetorit 1999, si I ndryshuar, mbi Ligjin e Aplikueshëm ne Kosove” . Sipas nenit 1.1 mbi Rregulloren No. 1999/1 “ te gjitha kompetencat ligjore dhe ekzekutive për Kosovën, përfshire administrimin e gjyqësorit, bartet nga UNMIK-u dhe aplikohet nga Përfaqësuesi Special I Sekretarit Gjeneral”. Pra nuk ka dyshim udhëzimet Administrative dhe Rregullative te UNMIK-ut bien nen kategorinë e “ instrumenteve Rregullative dhe ndihmese” siç parashihen me Rregulloren e UNMIK-ut no. 1999/24.¹³ Si pasoje Rregullorja e UNMIK-ut dhe Udhëzimet Administrative ishin te zbatueshme ne Kosove si ligj I zbatueshëm ne Kosove, dhe s’mund te konsiderohen *dispositive norm* siç pretendohen nga Mbrojtja.


22. Qe te dyja- Rregullorja e UNMIK-ut no. 2001/12 dhe 2001/7 si dhe udhëzimi Administrative no. 2003/09 hynë ne fuqi para kryerjes se veprës penale,¹⁴ dhe ishin për atë zbatueshme ne momentin kritik. Siç me te drejte u specifikua ne Aktgjykimin e Shkalles se Pare, Udhëzimi Administrativ është ende ne fuqi pasi qe nuk mund te konsiderohet qe “ mbulojnë çështjet qe janë te adresuara ne Kodin e Tanishëm” sipas Nenit 354 te KPK-se.¹⁵

¹² Rregullorja e UNMIK-ut no. 2001/12 Seksioni 1 definicioni “ (f)” “Organizate Terroriste” nënkupton një grup prej dy ose më shume personave, duke përfshire grupe te armatosura dhe grupe paramilitare, objektivat ose aktivitetet e te cilëve janë te drejtuara kah kryerja e terrorizmit

¹³ Sipas Rregullores e UNMIK-ut no.1999/24 e datës 12 Dhjetor 1999 mbi ligjin e aplikueshëm ne Kosovë, Seksioni 1 thotë se “ 1.1 Ligji i aplikueshëm ne Kosove duhet te jetë : (a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit Gjeneral dhe instrumentet ndihmese nën të; dhe (b) Ligji në fuqi ne Kosovë më 22 Mars 1989. Ne rast te një konflikti rregulloret dhe instrumentet ndihmese te lëshuara n[an te duhet te kenë përparësi”.

¹⁴ Rregullorja e UNMIK-ut no. 2001/12, seksioni 10; Rregullorja e UNMIK-ut no. 2001/7 Seksioni 13; Udhëzimi Administrativ no. 2003/9, Seksioni 3:” Udhëzimi Administrativ i tanishëm duhet të hyje në fuqi më 17 Prill 2003”.

¹⁵ Neni 354 I KPK-së: “(1) Dispozitat në Rregulloren e UNMIK-ut dhe Udhëzimet Administrative mbulon çështjet e adresuara në kodin e tanishëm duhet te ndalohen se pati efekt me hyrjen ne fuqi te Kodit të tanishëm vetëm nëse janë te caktuara qartë në Kod ose në Rregulloren e UNMIK-ut. 2) Dispozitat ne Kodin e zbatueshëm Penal duhet te përfundojnë se patur efekt me hyrjen në fuqi të Kodit të tanishëm.



23. Gjykata Supreme, për me tepër, pajtohet me konkluzionet e Gjykatës së Shkalles së Parë në ligjin që është me I favorshëm për të Akuzuarin, prandaj përputhet me Nenin 2 të KPK-se. Legjislacioni paraprak, Rregulloret e UNMIK-ut ishte ligji me I favorizuar për **A.S.** dhe prandaj janë të zbatueshëm në këtë rast.¹⁶


24. Përfundimisht, kjo Gjykatë ndan pikëpamjet me Mbrojtjen në lidhje me dënimin ndaj të Pandehurit për dy akuzat në lidhje me armët. **A.S.** u shpall fajtor për armëmbajtje pa leje ose substanca eksplozive sipas Pikës 2 të aktakuzës (Terrorizëm në kundërshtim me nenin 2.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/12 mbi Ndalimin me Ligj të Terrorizmit dhe Veprave Përkatese i lidhur me nenin 1 , shkronja (a) , numrat vii dhe x) nën Akuzën 3 (Armëmbajtje pa leje në kundërshtim me nenin 8.2 dhe 8.6 të Rregulloren të UNMIK-ut 2001/7 mbi Autorizimin e Armëmbajtjeve në Kosovë). Pika e parë a e akuzës ka të bëjë me të shtënat në ndërtesën e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë më 20 Korrik 2003 rreth orës 21:00 me raketë hedhës të mbajtur pa leje të tipit ZOLA, dhe e dyta ka të bëjë me mbajtjen në posedim të tri armëve të zjarrit AK 47 dhe 4 karikatorëve me municion pa leje autorizimi të gjetura në rezidencën e **A.S.** më 23 Korrik 2003.

25. Paneli i Gjykatës Supreme është i mendimit vepra e mbajtjes në posedim në mënyrë të kundërligjshme të armëve dhe karikatorëve bile nën nenin 1.a (x) të Rregullores së UNMIK-ut pasi që mbajtja në posedim e këtyre armeve është kryer " me qëllim që të shkaktohet rrezik serioz ndaj rendit publik, të detyroj qeverinë apo organizata ndërkombëtare, ose që të frikësoj ose rrezikoj popullatën civile". Ato në të vërtetë u gjetën tek banesa e **A.S.** vetëm tri ditë pas të shtënave në lokalet e Gjykatës së Qarkut.¹⁷ I pandehuri pranoi të ishte në posedim të atyre armeve. Përfundimisht, u vërtetua se ai ishte anëtarë i AKSH-së në kohën e asaj veprë penale.

26. Si pasojë, në pajtim me Neni 426 paragrafi 1 dhe Neni 417 i KPPK-së , dhe duke marrë parasysh përfitimin e të Pandehurit, Gjykata Supreme ndryshoi sipas detyrës zyrtare kualifikimin ligjor të Akuzës 3 duke e përfshirë nën Akuzën 2. Kështu që, **A.S.**

¹⁶ Gjykata e Qarkut në Prishtinë, çështja P no. 461/2007, Aktgjykimi i Gjykatës së Shkalles së Parë, 29 Qershor 2011, faqe 14: " Duke vendosur në ligjin e aplikueshëm penal, ky panel mori parasysh dispozitat e nenit 2 të KPK-së që thotë si në vijim: *ligji në fuqi në kohën kur vepra penale është kryer duhet të aplikohet tek kryesi i veprës dhe për me tepër në rast të ndonjë ndryshimi në ligjin e aplikueshëm tek çështja në fjalë para vendimit përfundimtarë ligji që është me i favorshëm për autorin e krimin duhet të aplikohet.* Pasi që të gjitha veprat penale ishin kryer para 6 Prillit 2004 kur edhe KPK-se hyri në fuqi, ky panel ishte i obliguar që të bëjë shqyrtimin dhe të vendosë se cilin ligj ishte më i favorshëm për **A.S.** Pas një vlerësimi të detalizuuar u arrit konkluzioni që ligji i mëparshëm është me i favorshëm për të pandenurin për shkak të faktit se dënimi i mundshëm sipas të dy ligjeve është i njëjtit dhe luan njejtë nga një deri në dhjetë vjet (akuza 1), dhjetë deri në njëzet vjet (akuza 2). Për akuzën e mbajtjes pa leje të armëve (akuza 3) seksioni 8.2 dhe 8.6 i Rregullores së UNMIK-ut No. 2001/7 mbi Autorizimin e Mbajtjes së Armëve në Kosovë përshkruhet me burg për kohëzgjatje për jo më tepër se 8 vjet ose me gjobë deri në 15000 DM ose të dyja bashkë, derisa neni 328 par. 2 i KPK-se parasheh për atë krim gjobë deri në 7500 EUR ose me burgim prej një deri në tetë vite. Në atë kohë duhet të përmendet neni 38 par. 1 i Kodit Penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë i cili e përshkruan se *dënimi me burg nuk mund të jete më i shkurtë se 15 ditë ose jo më i gjatë se 15 vite* duke i krahasuar këto dispozita ka baza të mjaftueshme që të thuhet se në lidhje me akuzën 3, si ligji më i favorshëm është rregullorja e UNMIK-ut pasi që dënimi i mundshëm mund të lëviz nga 15 ditë deri në 8 vite...".

¹⁷ Dosja përhirte. lënda e gjykatës së qarkut. **A.S.** vëllimi IV, foto album i bastisjes (lokacion: Kodra e Trimave, rruga aventura, Prishtinë)



dënohet për Terrorizëm në kundërshtim me nenin 2,1 të Rregullores së UNMIK-ut no. 2001/12 për të dy veprat.

Pretendimet se përcaktimi i gjendjes faktike i bëre nga Gjykata e Shkallës së Parë ishte i gabueshëm

27. Mbrojtja pretendon se nuk ka prova që **A.S.** të ketë kryer veprë të Terrorizmit sipas akuzës 1: fakti se letra ishte nënshkruar duke përdorur pseudonimin e tij të luftës nuk mjafton; asnjë ekspertizë grafologjike nuk është bërë; kushdo ka mundur të jete në posedim të letrës dhe zarfit. I pandehuri ka mundur te ketë kujdes shumë më të madhe nëse ai do të vepronte ashtu. Mbrojtja thekson se të shtënat ndodhën kur askush nuk ishte i pranishëm në ndërtesë dhe se granata nuk shkaktoi ndonjë dëm.

28. Prokurori i Shtetit thotë se ajo çka u gjetën nga Gjykata e Shkallës së Parë janë në përputhje me provat e paraqitura: mendimi i ekspertit në shenjat e gishtërinjve që identifikojnë shenjat e **A.S.**, ndërgjegjësimi i përmbajtjes së letrës nga i Akuzuari, fakti se **J.B.** në atë kohë ai ishte **XXX XXX XXX** dhe anëtar partie politike. Ai, për më tepër, thotë se nuk ka jo përputhshmëri ndërmjet deklaratave të dëshmitarit anonim dhe dëshmitarit **Z.B.** dhe i referohet përfundimeve të ekspertit të Balistikës **H.K.** dhe ekspertit të Forensikës **F.B.** lidhur me dëmtimet të shkaktuara nga plumbi. Prokurori i shtetit thekson se, në konen e të shtënave, **A.S.** ishte i vetëdijshëm që mund të kishte njerëz prezent në zyra dhe eksplozimi mund të shkaktonte lëndime të rënda trupore e edhe vdekje. Përfundimet e Gjykatës të Shkallës të Parë mbështeten drejt në faktet në vijim që nuk janë sfiduar nga Mbrojtja: në momentin kritik, AKSH-ja ishte organizatë terroriste dhe vepra kriminale janë kryer në emër të sajë.

29. Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me pretencën e Mbrojtjes lidhur me thurjen e situatës faktike dhe në këtë respekt ndan përfundimin me atë të Gjykatës të Qarkut.

30. Sa i përket Akuzës 1, në bindjen e Gjykatës Supreme, të gjitha elementet e dëshmisë të prezantuara para Trupit Gjykues janë të mjaftueshme që të vihet në përfundim të përgjegjesisë penale të të Pandehurit. Argumentin e Mbrojtjes që **A.S.** do të kujdesej më tepër po të sillej ashtu, dhe se kushdo mund të ketë qenë në pronësi të letrës dhe zarfit nuk qëndron. Gjykata e Qarkut jep shpjegim të detajuar në shkoqitjen dhe rëndësinë e dëshmisë, përfshi dhe besueshmërinë e dëshmitarëve dhe versionin e ngjarjeve sipas Mbrojtjes, dhe në përgjegjësinë e **A.S.**¹⁸ Trupi Gjykues, në Aktgjykim, i referohet të gjitha dëshmive në dispozicion, p.sh. natyra dhe përmbajtja e letrës (kërcënimet, mesazhe të natyrës politike) të nënshkruara nga **K.R.R.** Armata Kombëtare Shqiptare¹⁹, adresuesit e letrës **(J.B. XXX XX X)**, dëshmisë të tijë dhënë në gjyq në 17 Maj 2011 (posaçërisht që ai ishte i

¹⁸ Gjykata e Qarkut Prishtinë, çështja P nr. 461/2007. Aktgjykimi i Gjykatës të Shkallës së Parë. 29 Korrik. faqet 6 - 8

¹⁹ Dosja Gri. dosja e prokurorisë. HEP nr. 521/03. Vëllimi II: 698; zarfi dhe letra origjinale; fotografite e letrave dhe kopjet



angazhuar politikisht si anëtar i një nga partitë politike)²⁰, raportit të shenjave të gishtave²¹. Fakti që ekspertiza e grafologut nuk është kryer nuk përul përfundimet e Gjykatës të Shkallës të Parë. Si është theksuar në Aktgjykimin e kontestuar, ekspertiza u krye nga ekspert profesionist me eksperiencë të duhur, dhe është një pjesë e vlefshme e dëshmisë, Aktgjykimi i kontestuar gjithashtu përmban dhe arsyetimin e natyrës të veprës të kryer nga **A.S.** dhe qëllimin e tij për të kryer kundërvajtjen.

31. Sa i përket Akuzës 2 dhe 3, Gjykata Supreme e Kosovës përsëri është e mendimit që arsyetimi i Aktgjykimit të Shkallës së Parë përmban të tëra arsyetimet që të përfundohet që kundërvajtjet janë kryer nga i Pandehuri. Është vënë re që **A.S.** pranoi fajësinë për Akuzën 3 (akuzën e armës) ndaj Gjykata Supreme nuk duhej ta shqyrtojë këtë pikë... Sa i përket Pikës 2 (akuza e terrorizmit), Gjykata e Shkallës të Parë me imtësi shqyrtoi besueshmëritë e dëshmitarëve dhe deklaratave të tyre, si dhe të thënat e të pandehurit për ngjarjen. Gjykata Supreme e Kosovës plotësisht miraton përfundimet e shkallës të parë për besueshmërinë dhe seriozitetin të dëshmitarit Anonim dhe të dëshmitarëve²² të tjerë. Paneli gjithashtu ndan këndvështrimin e Gjykatës të Qarkut sa i përket mangësisë të mospërputhjeve dhe kundërthënive ndërmjet deklaratave të dëshmitarëve. Dëshmitari Anonim dha dëshmi të saktë se çka ngjau më 20 Korrik 2003 në afërsi të vendit të gjykatës dhe gjithashtu identifikoi të Pandehurin si personin që ai ka parë natën kritike. Gjykata Supreme e Kosovës pranon që deklaratat e Dëshmitarit **J.B.** nuk mund të konsiderohen si dëshmi të vlerës të lartë pasi që dëshmitari përmendi që ai ka harruar detajet asaj nate në fjalë. Në atë deklaratë të më hershme, ai gjithashtu pranon se ai nuk mban mend detaje të tjera për shkak se personi vraponte shumë shpejt dhe se ishte terr. Ky dëshmitar përmend në deklaratën e tij që "Pashë në person rreth 25-27 vjeç që vinte nga ana e djathtë e rrugës (nga Gjykata e Qarkut) dhe ai vraponte shumë shpejt, ai nuk tha gjë dhe vetëm vazhdoi të vrapojë në drejtim të bankës MEB (rruga e UÇK-së)" dhe dha përshkrim fizik të personit që kish parë që përputhet me atë të dhënë nga dëshmitari Anonim.²³ Ai deklaroi që dëgjoi eksplozimin rreth orës 21:05 – 21:10. Ai pa personin "pasi që dëgjoi eksplozimin për të cilin nuk e di se ku ndodhi, përnjëherë mbas një minute unë shkova para derës të oborrit dhe në rrugë". Mbetet që ai konfirmon deklaratën e më parme.²⁴ Gjykata Supreme e Kosovës më tutje vëren që më se tetë vjet kanë kaluar

²⁰ Gjykata e Qarkut Prishtinë, çështja P nr. 461/2007, procesverbali i seancës gjyqsore, 17 Maj 2011, faqet 2 - 7

²¹ Dosja Gri, dosja e prokurorisë. HEP nr. 521/03, faqe 69: raporti identifikues i forensikës FIS 03-265. fusha për shenjat e gishtave 03-261-F, dosja hetimore 03-11362 marrë në 20 Korrik: letra me zarf e shtypur: gjetën 2 të shtypura: faqe 64: dosja hetimore AFIS 03-11362, shenja gishtash të identifikueshme janë gjetur në letër, zarfi nuk ishte i përshtatshëm për AFIS gjurmim të fshehur: Dosja Gri, dosja e prokurorisë, HEP nr. 521/03, Vëllimi II, faqe 395, raporti identifikues i forensikës, gjurmët e gjetura në pjesën e parme të letres të adresuar për **J.B.** gjetën përputhje me shenjat e gishtave të **M.K.**, shenjat e gishtave që i takojnë **M.K.** janë gjetur në letren e adresuar për **J.B.** Dosja Gri, dosja e prokurorisë, HEP nr. 521/03, Vëllimi II, dëshmia e viktimës dhe dokumenti i letres kërcënuese kundër **J.B.** faqe 461 dhe në vazhdim, Dosja Gri, dosja e prokurorisë, HEP nr. 521/03, Vëllimi II, faqe 395 – 392, taqet 373 – 365: raporti identifikues i forensikës. çështia nr. 03-211-F, 7 Korrik 2003,

²² Dosja blu KA 135/2011 **A.S.** nga padia, Gjykata e Qarkut Prishtinë. çështja P nr. 461/2007 procesverbali i 11 Majit 2011, dëshmitari Anonim, faqja 3 e në vazhdim

²³ Dosja e himtë, dosja e prokurorisë. HEP nr. 521/03. vëllimi I, faqet 294-290

²⁴ Gjykata e Qarkut në Prishtinë. çështja P nr. 461/2007. Aktgjykimi i Shkallës të Parë, 29 Korrik 2003, fraja 10: "Deklarata e këtij dëshmitari nuk është e detajuar si deklarata e dëshmitarit anonim dhe ka mangësi



ndërmjet marrjes të asaj deklarate dhe deklaratës të tijë në gjyq. Harresa (në kohën e dhënies të dëshmisë së tijë në gjyq është e kuptueshme.

32. Kjo Gjykatë pranon një mos përputhje të lehtë që mund të ngrihet sa i përket drejtimit të marrë nga personi i identifikuar si **A.S.** i atë natë kritike. Dëshmitari **Z.B.** tha të personi vinte nga ana e djathtë e rrugës në drejtim të bakës MEB (rruga e UÇK-së), ndërsa dëshmitari Anonim përmendi në gjyq që ish nja 200 metra tutje nga ndërtesa e gjykatës të Qarkut, ai menjëherë shkoi jashtë të shohë mbrapa ndërtesës ku gjendet stacioni i autobusëve, pa dikënd që vinte nga drejtimi i ndërtesës të gjyqit dhe e ndoqi me shikim deri kur ai shkoi pranë xhamisë. Ai gjithashtu tha që vendi pranë rrugës ishte pjesërisht i ndriçuar edhe nga dritat e shitoreve, dhe se kaluan 5 minuta ndërmjet eksplodimit dhe momentit kur ai pa **Dj.** Gjykata Supreme e Kosovës është e mendimit që Paneli i Gjykatës të Qarkut qartë ka shpjeguar mospërputhjen në arsyetim. Që të dy dëshmitarët thanë që kanë parë personin në anën e njëjtë të rrugës (që çon qoftë te Xhamia ose te rruga e UÇK-së). Konfuzioni i krijuar në vend që vjen nga shpërthimi te ndërtesa e gjykatës duhet marrë parasysh gjatë vlerësimit të saktësisë të deklaratave të dëshmitarëve.

Për më tepër, Paneli i poshtë nënshkruar vëren që nuk mund që të përjashtohet që i Pandehuri ka filluar të ecë në një drejtim dhe ndërron mendje dhe merr tjetrin.

33. Gjykata Supreme e Kosovës gjithashtu nuk pajtohet me pretendimin e Mbrojtjes sa i përket faktit që të shtënat ndodhën kur kurrkush nuk qe prezent në ndërtesë dhe se granata nuk shkaktoi ndonjë dëm. Edhe pse ndodhi gjatë natës, **A.S.** ishte plotësisht i vetëdijshëm për dëmet e mundshme që mund të ndodhnin ane për mundësinë që në mjediset e gjykatës të ketë pasur persona në atë kohë. Sido, i Pandehuri e dinte që zona përreth Gjykatës të Qarkut është vend i ngjeshur dhe me disa shitore. Vetëdija e **A.S.** po ashtu konstatohet dhe me përdorimin e një arme aq të rrezikshme, siç dëshmonet nga raporti i ekspertëve, raporti i forensikës dhe të dëshmimeve të dëshmitarëve ekspert në gjykatë.²⁶ Ekspertiza erdhi në konkluzion që në shenjë gishti të marrë nga trupi i raketë shkrepësit që u përdor për të shtënë në mjediset e gjykatës përputhet me gishtin e madh të dorës të djathtë të **K.K.**²⁷ Fakti që kurrkush nuk u lëndua apo vlarë nuk

detajesh të rëndësishme siç bie fjala për identifikimin e të pandehurit, ky panel e konsideron si të besueshme.


Dëshmitari **Z.B.** dha përshkrim të njeriut të ri që la vendin e krimit që përputhet me përshkrimin të dhene nga dëshmitari anonim”: Dosja blu KA 135/2011 **A.S.** nga padia, procesverbali i seancës gjyqësore të 2 Qershorit 2011, faqet 12-15, dëshmitari **Z.B.**

²⁵ Dosja blu KA 135/2011 Amir Sopa nga padia, Gjykata e Qarkut Prishtinë, çështja P nr. 461/2007, procesverbali i seancës gjyqësore të 11 Majit 2011, dëshmitari Anonim, faqja 3 e në vazhdim; procesverbali i 27 Korrikut 2011, faqja 2

²⁶ Dosja e himtë, dosja e prokurorisë, **A.S.** Vëllimi IV, ndarja 5, raporti identifikues i forensikës, çështja e dosjes nr. 03-11371; Dosja e himtë, dosja e prokurorisë, HEP nr. 521/03, Vëllimi II, ndarësi i gjelbër, foto albumi, FIS dosja nr.03-265, i datës 20 Korrik 2003, foto albumi i vendngjarjes; Dosja blu KA 135/2011

A.S. nga padia, Gjykata e Qarkut Prishtinë, çështja P nr. 461/2007, procesverbali i seancës gjyqësore të 2 Qershorit 2011, faqet 3-8, dëshmia e ekspertit të balistikës **H.K.**; procesverbali i seancës gjyqësore të 9 Qershorit 2011, faqja 7 e në vazhdim, dëshmia e ekspertit **F.B.**; procesverbali i seancës gjyqësore të 9 Qershorit 2011, faqja w e në vazhdim, dëshmia e dëshmitarit **F.B.** administrator gjyqësor.

²⁷ Dosja e përhirte, dosja e prokurorisë, HEP no. 521/03, faqe 57; raporti i ekzaminimit të gishtave të 22 Korrik 2003, 4 shenja gishtash u gjetën në reket hedhës. Shenjat e gishtërinjve 3 dhe 4 ishin të pa identifikueshëm.



përrjashton ekzistencën e qëllimit nga i Pandehuri që të kryejë këto krime apo vetëdijen e tijë për pasojat e mundshme për veprimet e tija. Ndaj, Gjykata Supreme e Kosovës në këtë respekt plotësisht pajtohet me përfundimet e arritura nga Gjykata e Shkallës të Parë.

Sfida e vendimit mbi ndëshkimin penal

34. Mbrojtja ka pretendim që vendimi për ndëshkim penal është i pasaktë si pasojë e shkeljeve të parathëna. Nga ana tjetër, Gjykata e Shkallës të Parë ka dështuar në konsideratën e rrethanave lehtësuese dhe gabimisht ka arritur në përfundim që cenueshmëria e pronës nën mbrojtje, si element të *corpus delicti*, është konsideruar si rrethanë rënduese.

35. Prokurori i shtetit prezanton që Gjykata e Shkallës të Parë ka marrë parasysh të gjitha rrethanat lidhur me llogaritjen dhe shkallën e dënimit në përputhje me Nenin 34 të KPK.

36. Gjykata e Shkallës të Parë shqyrtoi rrethanat lehtësuese në vijim: mosha relativisht e re e të Pandehurit në kohën e kryerjes të veprës penale, fakti që “ai ka qenë një i ri relativisht i pa eksperiencë i cili lehtësisht ka qenë vënë në shënjestër nga ideologjia e rrezikshme e terrorizmit si mjet për të zgjidhur konflikte politike”, koha që ka kaluar që nga kryerja e veprës. Trupi Gjykues gjithashtu mori në konsideratë rrethanat rënduese: intensiteti i lartë i rrezikut për vlerat e mbrojtura domethënë rrezik substancial për shëndetin dhe jetën e shumë njerëzve sjelljen në rrezik të rënde të pronave me vlere të rëndësishme.²⁸ Aktgjykimi i sfiduar gjithashtu i referohet faktit se **A.S.** shte fshehur për disa vite. Gjykata e Shkallës se Parë për me tepër sjell arsyetim të gjatë për këto rrethana dhe për shqiptimin e dënimit të rënde prej dhjetë vitesh dhe një muaji për të Pandehurin. Gjykata Supreme e Kosovës pra konfirmon se Gjykata e Shkallës se Parë me të drejte vendosi për dënimin që do të shqiptohet, në pajtueshmëri me Nenin 64 të KPPK-së.

37. Duke marrë parasysh çka u tha me lartë, Kërkesa nga Mbrojtja për ndërprerjen e paraburgimit hidhet poshtë si e pabazë.

38. Është vendosur si në dispozitiv.

F-1 gjeti përputhje, gishti i madh i dorës së djathtë- të Kadri Kamberit i lindur me 13 Shkurt 1978; Mendimi i ekspertit të gjurmëve të gishtërinjve AFIS dosja no. 03-148-CAF, faqe 54; krahasimi i ekzaminimit të 4 shiritave transparent të gjurmëve të gishtërinjve dhe 10 shiritave standard të gjurmëve të gishtërinjve të **K.** vetëm F-1 është i përshtatshëm për ekzaminim: F-1 e marrur nga trupi i raketë hedhësit, seritë 8814 1233 përputhet me shenjat e gishtërinjve të **K.K.**, gishti i madh i dorës së djathtë; Dosja e përhitje dosja e prokurorisë, HEP no. 521/03, vëllimi III, faqe 932; Mendimi i ekspertit të shenjave të gishtërinjve dosja AFISno. 03-148-CAF, faqe 924; dokumenti nga objekti i paraburgimit të Bondstillit, Kosovë, no. KS015282, të 18 Shkurtit 2001, shenjat e gishtërinjve të **K.K.** data e lindjes **X X X**
²⁸ Gjykata e Qarkut të Prishtinës, çështja P no. 461/2007. Aktgjykim i Shkallës se Parë. Qershor 2001.
faqe 13



Kryetar i kolegjit

Horst Proetel, Gjyqtar i EULEX-it

Anëtare e kolegjit

Marije Ademi, Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Anëtar i kolegjit

Tore Thomassen, Gjyqtar i EULEX-it

Anëtare e kolegjit

Valdete Daka, Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Anëtar i kolegjit

Salih Toplica, Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Procesmbajtëse

Chiara Rojek, Zyrtare ligjore

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Ap-Kz no. 166/2012

4 Dhjetor 2012

Prishtinë



Republika Kosovo

SAKËSHË E KOPJËS E VËRTETON
TAÇNOSTI OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Gjykatçerri radnik